



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK TIRANË**

V E N D I M

Nr.141 dt.29.09.1997

**MBI
STRUKTURIMIN ARTISTIK TË QENDRES EKONOMIKE
KULTURES VIZUALE TE TIRANES.**

Këshilli Bashkiak i Tiranës, pasi mori në shqyrtim relacionin e Drejtorisë së Kulturës për Strukturimin Artistik të Qendrës Ekonomike Kulturore Vizuale të Tiranës, në mbështetje të ligjit Nr.7572, dt.10.06.1992, neni.14, pika.9 dhe 13 dhe të vendimit të po këtij këshilli Nr.29, dt.14.02.1997

VENDOSI

1. Të miratoj veprimtarinë artistike krahas asaj Ekonomike të Qendrës Ekonomike të Kulturës Vizuale të Tiranës.
2. Të miratoj struktura artistike krahas asaj administrative dhe teknike të Qendrës Ekonomike Kulturore Vizuale të Tiranës duke ja bashkangjitur strukturën të miratuar në vendimin Nr.29, dt.14.02.1997 të këtij këshilli.
3. Veprimtaria e këtij institucioni do të kalojë në mjediset e Ndërmarrjes Artistike Përpunim Drurit të Tiranës.
4. Veprimtaria e mbetur e Ndërmarrjes Artistike Përpunim Druri konceptohet si veprimtari të kulturës popullore të artizanatit dhe vihet në vartësi të kësaj qendre.
5. Zbatimin e këtij vendimi e ndjek Drejtoria e Kulturës.
6. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

ORHAN SAKIQI

